



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 58-të, të mbajtur më 23 korrik 2018, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegjit "ISPE":
 - Ekonomik, BA, 180 ECTS,
 - Juridik, LLB, 240 ECTS,
 - Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, dhe
 - Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS.
2. Hiqet masa e pezullimit për programin e studimit të BPrAL Kolegjit "ISPE" :
 - Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS
3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (tash e tutje UA për Akreditim), neni 21 dhe 26, pika 5.3.4, Agjencia e Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA) me datë 23 maj 2018 ka kërkuar nga të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (tash e tutje IAL) që ti dorëzojnë listat e stafit akademik për secilin program të studimit. Në afatin e caktuar nga AKA, BPrAL Kolegjit "ISPE" ka dorëzuar listat e kërkuara nga AKA për programet e studimit.

Bazuar ne te dhënat e prezantuara nga ky IAL, për programet e studimit: Ekonomik, BA, 180 ECTS, Juridik, LLB, 240 ECTS, Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS (sipas kërkesës së AKA-së datë 23.05.2018) konfirmohet se për këto programe të studimit nuk ka staf akademik të mjaftuar të fushës së studimit si bartës të programeve të cekura me lartë.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 kërkohet që: “Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD apo titull të barasvlershëm artistik nga fusha e programit të studimeve”. Pra siç mund të shihet nga sa u tha me sipër, kërkohet që për çdo 60 ECTS, IAL duhet të ketë një person në marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore PhD dhe të jetë i fushës së programit të studimit.

1. Për programin e studimit: Ekonomik, BA, 180 ECTS, BPrAL Kolegjit “ISPE” si bartës të këtij programi të studimit ka vendosur: Ramadan Beqiri, Alfred Halilaj, Rifat Demalija, Rezak Jakupi, Mariela Lazi, dhe Oreta Saliaj. Pas kontrollimit të dokumentacionit të kualifikimit për secilin bartës të këtij programi të studimit, u konstatua që asnjëri nga personat e vendosur si bartës të këtij programi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë bartës të këtij programi sipas dispozitave ligjore në fuqi. Pas verifikimit të marrëdhënies së punës për të gjitha bartësit e programeve të studimit përmes Administratës Tatimore të Kosovës (tash e tutje ATK) u konfirmua që Ramadan Beqiri ka marrëdhënie të rregullt pune në sektorin publik të Kosovës, si punë primare. Për të njëjtin staf përmes deklaratës personale edhe Kolegji Iliria me datë 14.05.2018 ka dorëzuar dosjen e këtij personi dhe ku konfirmohet krijimi i marrëdhënies së rregullt të punës me këtë institucion.

Sipas nenit 26, pika 5.3.14 e UA për Akreditim 9/2017, (datë 02.08.2018): “Një anëtar i stafit akademik që është i punësuar me orar të plotë (40 orë në javë) në një institucion të arsimit të lartë mund të kryejë detyra në institucione tjera të akredituara me më së shumti 10 orë angazhim në ligjërata, ushtrime ose mentorim të kandidatëve, që nënkupton gjysmën e normës së plotë prej 20 orë pune”. Rrjedhimisht pas verifikimit të angazhimit të tij, ky staf nuk mund të jetë bartës i programit të studimit.

Bartësit e tjerë të këtij programi, siç janë: Alfred Halilaj (Dr.sc Etnologji dhe Folklor), Rifat Demalija (Dr.sc i Shkencave Sociale, në profilin Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare), Rezak Jakupi (Dr.sc në Sociologji), Mariela Lazi (Dr.sc në Psikologji), dhe Oreta Saliaj (Dr.sc në Shkenca Politike), asnjëri nuk janë të fushës së programit të studimit, andaj bazuar në nenin 26, pika 5.3.4, sipas se cilës kërkohet që bartësit e programeve të studimit duhet të jenë të fushës së studimit, këta persona nuk mund të jenë bartës të programit në Ekonomik, BA, 180 ECTS, dhe mbi këtë bazë KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

2. Për programin e studimit: Juridik, LLB, 240 ECTS, BPrAL Kolegjit “ISPE” si bartës të këtij programi të studimit ka vendosur: Ndricim Ciroka, Irisi Menga, Klementina Ngjeci, Ismail Kamberi, Lulzim Hoxha, Shkelqim Sirika. Pas kontrollimit të dokumentacionit të kualifikimit për secilin bartës të këtij programi të studimit, u konstatua që vetëm Irisi Menga është i fushës së Juridikut. Bartësit e tjerë të këtij programi, siç janë: Ndricim Ciroka (Dr.sc në Ekonomiks dhe Agrobiznes), Klementina Ngjeci (Dr.sc. në Gjeografi), Ismail Kamberi (Dr.sc në Filologji, gjithashtu i mungon Leje qëndrimi i Republikës së Kosovës), Lulzim Hoxha (Dr.sc i Shkencave Sociale, në profilin Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare), Shkelqim Sirika (Dr.sc në Gjeografi), asnjëri nuk janë të fushës së programit të studimit, andaj bazuar në nenin 26, pika 5.3.4, sipas se cilës kërkohet që bartësit e programeve të studimit duhet të jenë të fushës së studimit, këta persona nuk mund të jenë bartës të programit në Juridik, LLB, 240 ECTS, dhe mbi këtë bazë KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


3. Për programin e studimit: Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, BPrAL Kolegjit "ISPE" si bartës të këtij programi të studimit ka vendosur: Fisnik Ferati dhe Aleksander Muskaj. Pas kontrollimit të dokumentacionit të kualifikimit për secilin bartës të këtij programi të studimit, u konstatua që asnjëri nga bartësit e këtij programi të studimit nga ka nostifikim (njohje të diplomës nga MASHT) të diplomës. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: për qellim të punësimit, këto diploma duhet të nostifikohen nga MASHT. Përveç kësaj për programin tre vjeçare (me 180 ECTS), sipas UA për Akreditim, neni 26, pika 5.3.4, duhet të jenë se paku tre bartës të programi të studimit dhe të jenë të fushës së studimit, ndërsa Kolegji ISPE për këtë program ka vendosur vetëm dy persona. Bartësi i këtij programi Fisnik Ferati, përveç që i mungon nostifikimi i diplomës, nuk është as i fushës së programit të studimit. Ky staf i përket fushës ekonomike, dhe jo të Shkencave Politike. Andaj mbi këto fakte, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
4. Për programin e studimit: Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS, BPrAL Kolegjit "ISPE" si bartës të këtij programi të studimit ka vendosur: Fejzi Lila (Dr.sc në Shkenca Sociale, në profilin Shkenca Politike), Petrit Perhati (Dr.sc në Ekonomi, profili në Menaxhment). Pas kontrollimit të dokumentacionit të kualifikimit për secilin bartës të këtij programi të studimit, u konstatua që Petrit Perhati është i fushës së Ekonomis, profili në Menaxhment, dhe jo i shkencave të sigurisë. Në mungesë të stafit sipas UA për Akreditim, neni 26, pika 5.3.4, ku kërkohet që për çdo 60 ECTS të jetë një staf akademik me gradën shkencore PhD (Dr.sc.), dhe të jenë të fushës së studimit, për programin e studimit, Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS, sipas këtij udhëzimi, BPrAL Kolegjit "ISPE" duhet të ketë se paku dy staf akademik me gradën Dr.sc., dhe të jenë të fushës së programit. Duke e parë që ky program nuk ka staf akademik të fushës së programit të studimit, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
5. Për programin e studimit: Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, pas vlerësimit të dokumentacionit relevant të stafit akademik, KSHC vlerësoi që ky staf i plotëson kushtet për të qenë bartës i programit të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në nenin 21, pika 1 e UA për Akreditim (9/2017), thuhet: "AKA e rezervon të drejtën të monitoroj dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim". Ndërsa sipas pikës 2 të nenit 26 të UA për Akreditim thuhet: "AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur". Bazuar në këtë çka u tha me sipër dhe në mungesë të stafit akademik të fushës së studimit për programet e studimit: Ekonomik, BA, 180 ECTS; Juridik, LLB, 240 ECTS; Shkenca Politike, BA, 180 ECTS; Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegjit "ISPE";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

